

20160531346

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15 dhe 154/15) në nenin 7 paragrafi (4) pas numrit "93" shtohen fjalët: "93-a,", ndërsa pas numrit "94," shtohen fjalët: "94-a,".

Neni 2

Në nenin 31 pas paragrafit (8) shtohet paragraf i ri (9) si vijon:

"(9) grumbulluesi është i obliguar më së voni deri më 15-in e muajit rrjedhës në formë elektronike të dorëzojë të dhëna për grumbullim të realizuar të prodhimeve bujqësore nga muaji paraprak dhe për grumbullimin e planifikuar të prodhimeve bujqësore për muajin e radhës."

Paragrafi (9) i cili bëhet paragraf (10) ndryshon si vijon:

"(10) Lloji i të dhënave nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, mënyra e dorëzimit, formën dhe përmbajtjen e formularit për dorëzimin e të dhënave i përcakton ministri."

Pas paragrafit (10) shtohet paragraf i ri (11) si vijon:

"(11) Të dhënat nga paragrafët (8) dhe (9) mund të shfrytëzohen për nevojat e sistemit informativ bujqësorë të tregut nga neni 13 i këtij ligji."

Neni 3

Në nenin 32 paragrafi (5) numri "180" zëvendësohet me numrin "90".

Paragrafi (6) shlyhet.

Paragrafi (7) i cili bëhet paragraf (6) ndryshon si vijon:

"Grumbulluesi është i obliguar të dhënat e marrëveshjes nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe ndryshimet e të dhënave ti fusë në formë elektronike në regjistër nga neni 4 të këtij ligji. "

Paragrafët (8), (9) dhe (10) bëhen paragrafë (7), (8) dhe (9).

Në paragrafin (11) i cili bëhet paragraf (10) fjalët: " paragrafi (10)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (9)".

Paragrafët (12), (13) dhe (14) bëhen paragrafë (11), (12) dhe (13).

Neni 4

Neni 33 ndryshon si vijon:

"(1) Grumbulluesit e prodhimeve bujqësore parashtrojnë kërkesë te Ministria për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve të prodhimeve bujqësore.

(2) Personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë i cili e mban procedurën për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve të prodhimeve bujqësore dhe regjistrin e importuesve të prodhimeve të caktuara bujqësore është i obliguar në afat prej tre ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni me detyrë zyrtare të parashtrojë kërkesë për sigurimin e dokumenteve për plotësimin e kushteve nga neni 31 paragrafi (6) alineja 1 nga ky ligj te organi kompetent publik.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dëshmitë dhe dokumentet nga paragrafi (2) i këtij neni është i obliguar t'i dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(4) Ministria miraton vendim për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve të prodhimeve bujqësore respektivisht vendim për refuzimin e kërkesës për regjistrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(5) Kundër vendimit të Ministrisë për refuzimin e kërkesës për regjistrim nga paragrafi (4) i këtij neni kërkuesi ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Komisioni për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë.

(6) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e plotësimit të kushteve nga neni 31 i këtij ligji i përcakton ministri në pajtim me ministrin për Shoqëri informatike dhe administratë."

Neni 5

Në nenin 34 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Regjistri i grumbulluesve të prodhimeve bujqësore mbahet në formë elektronike dhe përmban të dhëna nga neni 31 paragrafët (8) dhe (9), neni 32 paragrafi (2) dhe nga kërkesa për regjistrim nga neni 33 i këtij ligji."

Neni 6

Në nenin 35 paragrafi (2) ndryshon si vijon:

„Kundër vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni grumbulluesi mundet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtës të paraqesë ankesë te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedure për marrëdhënie pune në shkallë të dytë.”.

Neni 7

Në nenin 36 paragrafi (2) alineja 3 ndryshon si vijon:

"- të disponojnë me objekte adekuate për ndërmarrjen, klasifikimin, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore".

Në paragrafin (5) fjalët „33, 34 dhe 35“ zëvendësohen me fjalët: “33, 34, 35 и 36-a“.

Neni 8

Pas nenit 36 shtohet nen i ri 36-a si vijon:

"Neni 36-a

(1) Importuesit parashtrajnë kërkesë te Ministria për regjistrim në regjistrin e importuesve të prodhimeve të caktuara bujqësore.

(2) Personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë i cili e mban procedurën për regjistrim në regjistrin e importuesve të prodhimeve të caktuara bujqësore është i obliguar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni me detyrë zyrtare të parashtrijë kërkesë për sigurimin e dokumenteve për plotësimin e kushteve nga neni 36 paragrafi (2) alineja 1 nga ky ligj te organi kompetent publik.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dëshmitë dhe dokumentet nga paragrafi (2) i këtij neni është i obliguar t'i dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(4) Ministria miraton vendim për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve të prodhimeve të caktuara bujqësore respektivisht vendim për refuzimin e kërkesës për regjistrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(5) Kundër vendimit të Ministrisë për refuzimin e kërkesës për regjistrim nga paragrafi (4) i këtij neni kërkuesi ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë."

Neni 9

Në nenin 47 paragrafi (1) pas fjalës "ekonomi" shtohen fjalët: "dhe grumbulluesve të prodhimeve bujqësore të regjistruar në regjistrin nga neni 33 i këtij ligji".

Në paragrafin (2) pas fjalës "kafshë" vihet presje dhe shtohen fjalët: "ndërsa grumbulluesve të prodhimeve bujqësore të regjistruar në regjistrin nga neni 33 i këtij ligji për prodhimet e grumbulluara bujqësore".

Neni 10

Në nenin 48 paragrafi (1) alineja 5, lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 6 pika zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pas alinesë 6 shtohet aline e re 7 si vijon:

"- regjistri i grumbulluesve të prodhimeve bujqësore."

Neni 11

Në nenin 50 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Grumbulluesit e prodhimeve bujqësore të regjistruara në regjistër nga neni 33 i këtij ligji kërkesë për pagesa të drejtpërdrejta parashtrajnë kur ajo parashihet me programin vjetorë për përkrahje financiare në bujqësi."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 12

Në nenin 57 pas paragrafit (4) shtohen dy paragrafë të rinj (5) dhe (6) si vijon:

"(5) Shmangia në më shumë kushte minimale për praktikë të mirë bujqësore dhe mbrojtjen e mjedisit jetësorë nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni që u takojnë sferës së njëjtë të kushteve të përputhshmërisë së kryqëzuar konsiderohet për një shmangie me atë që përqindja e zvogëlimit llogaritet si vlerë mesatare e përqindjeve të shmangieve të ndryshme.

(6) Mënyrën e përcaktimit të mospërputhshmërisë dhe lartësisë së përqindjes së zvogëlimit të pagesave të drejtpërdrejta nga paragrafi (1) i këtij neni më afër i përcakton ministri."

Neni 13

Në nenin 59 paragrafi (1) pas fjalës "Ministria" shtohen fjalët: "ose Agjencia për ushqim dhe veterinar".

Neni 14

Në nenin 62 paragrafi (3) pas presjes numrit "70" i shtohen fjalët: "70-a".

Neni 15

Në nenin 65 paragrafi (1) pika 2), pas alinesë 1 shtohet aline e re 2 si vijon:

"- ristrukturimi i ekonomive bujqësore".

Neni 16

Në nenin 70 paragrafi (8) ndryshon si vijon:

"Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni nuk u ndahet ekonomive bujqësore të cilat bartës është personi juridik i cili shfrytëzon ndihmë për publikim dhe rikonstruktiv në pajtim me Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore dhe përkrahje nga neni 70-a i këtij ligji."

Në paragrafin (11) numri "(11)" zëvendësohet me numrin "(10)".

Neni 17

Pas nenit 70 shtohet titull i ri dhe nen i ri 70-a si vijon:

"Investime për ristrukturimin e ekonomive bujqësore

Neni 70-a

(1) Përkrahja për investime për ristrukturimin e ekonomive bujqësore ndahet u ndahet për rritjen e kapaciteteve prodhuese të ekonomive bujqësore.

(2) Shfrytëzuesi i përkrahjes nga paragrafi (1) i këtij neni është ekonomi bujqësore familjare i regjistruar në RVEB dhe bartës i të cilit është në moshën deri 50 vjet në ditën e parashtrimit të kërkesës për përkrahje financiare.

(3) Kapacitete e ekonomive bujqësore grupohen në tre grupe, edhe atë:

- grupi i parë: kapacitete me madhësi deri më 1 ha për pemëtari dhe vreshtari, deri 5 ha për drithëra dhe ushqim për kafshët, deri më 1 ha për kultura foragjere, deri më 100 krerë dhensh, deri më 10 krerë dhish, deri më 5 krerë dosë, deri më 4 krerë lopë dhe deri më 30 dema të majmë

- grupi i dytë: kapacitete me madhësi mbi 1 ha për pemëtari dhe vreshtari, mbi 5 ha deri 10 ha për drithëra dhe ushqim për kafshët, mbi 1 ha deri 3 ha për kultura foragjere, prej 101 deri më 300 krerë dhensh, prej 11 deri më 25 krerë dhish, prej 6 deri më 10 krerë dose, prej 5 deri më 10 krerë lopë dhe prej 31 deri më 40 dema të majmë.

- grupi i tretë: kapacitete me madhësi mbi 3 ha deri 5 ha për pemëtari, mbi 3 ha deri 10 ha për vreshtari, mbi 10 ha deri 50 ha për drithëra dhe ushqim për kafshët, mbi 3 ha deri 8 ha për kultura foragjere, prej 301 deri 500 krerë dhensh, prej 26 deri 50 krerë dhi, prej 11 deri 50 krerë dose, prej 11 deri 20 krerë lopë dhe mbi 40 dema të majmë.

(4) Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni është dedikuar për investime për blerjen e tokës bujqësore, furnizimin e shpezëve të gjalla dhe bimëve shumëvjeçare, ndërtimin dhe rikonstruktimin e objekteve dhe furnizimin e mekanizmit dhe pajisjes edhe për shfrytëzimin e kushteve adekuate në bujqësi.

(5) Lartësia e përkrahjes nga paragrafi (1) i këtij neni arrin 50% të shpenzimeve të pranueshme dhe të bëra për realizimin e investimit nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni ndahet me shfrytëzim të detyrueshëm të kushteve këshillëdhënëse gjatë realizimit të investimeve nga paragrafi (4) i këtij neni.

(7) Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet përmes planit afarist të ekonomisë bujqësore, dhe me të cilën parashihen aktivitete investuese për periudhë prej të paktën tre vjet, në mënyrë adekuate për rritjen e planifikuar të kapaciteteve prodhuese të ekonomisë bujqësore në suaza të grupit të njëjtë respektivisht nga njëri grup në tjetrin.

(8) Planit afarist nga paragrafi (7) i këtij neni i përmban të paktën elementet nga neni 67 paragrafi (4) i këtij ligji.

(9) Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet me marrëveshje në kohëzgjatje deri më tre vjet. Përkrahja nga paragrafi (1) i këtij neni paguhet në pajtim me fazat e plotësimit të aktiviteteve investuese nga plani afarist nga paragrafi (7) i këtij neni."

Neni 18

Në nenin 90 paragrafi (2) pas presjes numrit "70" i shtohen fjalët: "70-a".

Neni 19

Pas nenit 93 shtohet titulli i ri dhe neni i ri 93-a si vijon:

"Ndihmë për investime për ristrukturimin e ekonomive bujqësore

Neni 93-a

(1) Ndihmë shtetërore për investimet për ristrukturimin e ekonomive bujqësore është përkrahje plotësuese financiare e masës nga neni 70-a i këtij ligji.

(2) Lartësia e ndihmës nga paragrafi (1) i këtij neni arrin:

- 90% të shpenzimeve të pranueshme dhe pa pranueshme për realizimin e investimit me të cilin kapacitetet e ekonomisë bujqësore kalojnë nga grupi i parë në të dytin dhe nga neni 70-a paragrafi (3) të këtij ligji dhe

- 70% të shpenzimeve të pranueshme dhe pa pranueshme për realizimin e investimit me të cilin kapacitetet e ekonomisë bujqësore kalojnë nga grupi i dytë në të tretin nga neni 70-a paragrafi (3) të këtij ligji, respektivisht 80% për shfrytëzimin e shërbimeve këshillëdhënëse në bujqësi.

(3) Ekonomitë bujqësore të cilët janë shfrytëzues të investimeve nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të paktën tre vjet të njëpasnjëshme të paraqesin kapacitete në pajtim me grupin fillestar para fillimit të investimit, dhe gjatë kalimit në grupin tjetër, madhësia e kapaciteteve të reja duhet të jetë më e madhe nga ato fillestare të paktën për:

- 100% për investimet nga paragrafi (2), alineja 1 të këtij neni, dhe

- 50% për investimet nga paragrafi (2), alineja 2 të këtij neni."

Neni 20

Pas nenit 94 shtohet titull i ri dhe nen i ri 94-a si vijon:

"Ndhimë për investime në përpunim dhe marketing

Neni 94-a

(1) Ndhimë për investime në përpunimin dhe marketingun e përkrahjes plotësuese financiare të masës nga neni 72 i këtij ligji.

(2) Lartësia e ndihmës nga paragrafi (1) i këtij neni, duke përfshirë edhe përkrahjen nga neni 72 i këtij ligji, arrin deri 80% të lartësisë së shpenzimeve të pranura investuese kur bartësi i investimit është shoqëri tregtare nga sfera e bujqësisë, përpunimit ose tregtisë me prodhime bujqësore bazuar nga partnerët e evidentuar ekonomik në pajtim me nenin 24 të këtij ligji, të cilët paraqesin nënsektor të prodhimeve bujqësore ose grupe të prodhimeve nga neni 22 paragrafi (4) të këtij ligji.

(3) Themeluesit e shoqërisë tregtare nga paragrafi (2) i këtij neni në vitin paraprak nga viti i parashtrimit të kërkesës së ndihmës nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të kenë realizuar të paktën 50% nga prodhimet e përgjithshme tregtare ose të prodhuara në Republikën e Maqedonisë me çka ka të bëjë investimi.

(4) Gjithsej prodhimet e prodhuara respektivisht të tregtuara në Republikën e Maqedonisë me të cilat ka të bëjë investimi përcaktohen në pajtim me të dhënat e Entit Shtetërorë për statistikë.

(5) Ndhimja nga paragrafi (1) i këtij neni ndahet në mënyrë të para financimit të investimit.

(6) Para financimi i investimit është pagimi i shumës së ndihmës për realizimin e investimit të shfrytëzuesit para fillimit të investimit duke përfshirë edhe shumën e kofinancimit privat.

(7) Në pajtim me programet nga neni 7 i këtij ligji, parafinancimi i investimeve ndahet në pajtim me fazat e realizimit të investimit.

(8) Ndhimja për investime në përpunimin e marketingut ndahet me marrëveshje të lidhur ndërmjet shfrytëzuesit të ndihmës dhe Agjencisë.

(9) Shfrytëzuesi i ndihmës është i obliguar para lidhjes së marrëveshjes te Agjencia të dorëzojë garanci bankare ose hipotekë në vlerë të para financimit të lejuar në pajtim me fazat për realizimin e investimit si garanci për kryerjen kualitative dhe në kohë të marrëveshjes nga paragrafi (8) i këtij neni.

(10) Shuma e parafinancimit të paguar të ko financimit privat, shfrytëzuesi është i obliguar pas përfundimit të investimit ta kthejë për më shumë se tetë këste të barabarta vjetore.

(11) Agjencia pas përfundimit të investimit një herë në vit miraton vendim për kthimin e mjeteve nga paragrafi (10) i këtij neni me të cilin përcaktohet shumë e mjeteve dhe afat për kthim.

(12) Shfrytëzuesi i ndihmës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon ta tjetërsojë, ngarkojë, ta japë me qira ose në çfarë mënyre tjetër ta ngarkojë investimin në afat prej tetë vitesh nga përfundimi i investimit, përveç se për nevojat nga paragrafi (9) i këtij neni.

(13) Në raste të tjetërsimit të investimit pas skadimit të afatit nga paragrafi (12) i këtij neni, shfrytëzuesi i ndihmës është i obliguar ndihmën ta kthejë në afat prej 15 ditësh nga dita tjetërsimit.

(14) Çdo marrëveshje ose akt tjetër juridik që është në kundërshtim me paragrafin (12) të këtij neni është i pavlefshëm."

Neni 21

Në nenin 98 paragrafi (1) fjalët: "ekonomi për prodhim primar bujqësorë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga ngjarjet e pavolitshme klimatike" zëvendësohen me fjalën "prodhim.

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Lartësia e ndihmës nuk do të tejkalojë 60% nga shpenzimi i premisë për sigurimin e kompensimit të dëmit mbi prodhimin bujqësorë, por jo më shumë se 200.000 denarë për ekonominë bujqësore."

Neni 22

Në nenin 101 paragrafi (1) në alinenë 7 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, ndërsa në alinenë 8 pika zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pas alinesë 8 shtohet aline e re 9 si vijon:

"- grumbullimi i të dhënave për hartën e tokës, mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të hartës së të dhënave, analiza dhe publikimi i të dhënave për tokat."

Neni 23

Neni 119 ndryshon si vijon:

"(1) Organizata e prodhuesve parashtrohet te Ministria për regjistrim në Regjistrin e organizatave të prodhuesve.

(2) Personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë i cili e mban procedurën për regjistrim në regjistrin e organizatave të prodhuesve është i obliguar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni me detyrë zyrtare të parashtrojë kërkesë për sigurimin e dokumenteve për plotësimin e kushteve nga neni 114 paragrafi (1) alineja 1 dhe 4 nga ky ligj te organi kompetent publik.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dokumentet nga paragrafi (2) i këtij neni është i obliguar t'i dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(4) Ministria miraton vendim për regjistrim në regjistrin e organizatave të prodhuesve respektivisht vendim për refuzimin e kërkesës për regjistrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(5) Kundër vendimit të Ministrisë nga paragrafi (4) i këtij neni kërkuar ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit te Komisioni shtetërorë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë.

(6) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e plotësimin të kushteve nga neni 114 i këtij ligji i përcakton ministri."

Neni 24

Neni 126 ndryshon si vijon:

"(1) Grupi i prodhuesve parashtron kërkesë te Ministria për regjistrim në Regjistrin e grupit të prodhuesve.

(2) Personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë i cili e mban procedurën për regjistrim në regjistrin e grupit të prodhuesve është i obliguar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni me detyrë zyrtare të parashtojë kërkesë për sigurimin e dokumenteve për plotësimin e kushteve nga neni 122 paragrafi (2) alineja 1 dhe 4 nga ky ligj te organi kompetent publik.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dokumentet nga paragrafi (2) i këtij neni është i obliguar t'i dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(4) Ministria miraton vendim për regjistrim në regjistrin e grupit të prodhuesve respektivisht vendim për refuzimin e kërkesës për regjistrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(5) Kundër vendimit të Ministrisë nga paragrafi (4) i këtij neni kërkuesi ka të drejtë për ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë.

(6) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e plotësimin të kushteve nga neni 122 i këtij ligji i përcakton ministri.”.

Neni 25

Në nenin 165 paragrafi (1) alineja 6 shlyhet.

Neni 26

Pas nenit 165 shtohet nen i ri 165-a si vijon:

"Neni 165-a

(1) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar të Ministrisë për Bujqësi Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave, nëse:

- nuk parashtron kërkesë për sigurimin e dokumenteve me detyrë zyrtare në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës në kundërshtim me nenet 33 paragrafi (2), 36-a paragrafi (2), 119 (2) dhe 126 paragrafi (2) nga ky ligj dhe

- nuk vendos për kërkesën në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës në kundërshtim me nenet 33 paragrafi (4), 36-a paragrafi (4), 119 paragrafi (4) dhe 126 paragrafi (4) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shume prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet si kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dokumente nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara dhe dokumentet në afat prej tre ditësh në kundërshtim me nenin 33 paragrafi (3), neni 36-a paragrafi (3), neni 119 paragrafi (3) dhe neni 126 paragrafi (3) të këtij ligji.

(3) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente."

Neni 27

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 28

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 29

Dispozitat nga nenet 4, 8, 23, 24 dhe 26 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".